



Bashkimi Evropian
Misioni Përcjellës i Zgjedhjeve

KOSOVË 2022

Raporti Përfundimtar

Nëntor- Dhjetor 2022



Misioni Përcjellës i Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian Kosovë*

Nëntor - Dhjetor 2022

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

“Misionet përcjellëse të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian janë të pavarura nga institucionet e Bashkimit Evropian. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën dhe qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.”

***Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.**

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	Përmbledhje ekzekutive	1
II.	Informacion rreth Misionit.....	2
III.	Konteksti	3
A.	Zhvillimet lidhur me zgjedhjet.....	3
B.	Konteksti politik.....	5
C.	Veprimet e BE-së për misionin përcjellës të EOM-së	6
IV.	Statusi i zbatimit të rekomandimeve të EOM-së	6
A.	Administrimi i zgjedhjeve.....	6
B.	E drejta e votës dhe regjistrimi i votuesve	7
C.	Partitë politike, financimi i partive politike dhe fushata zgjedhore	9
D.	Mediat.....	11
E.	Pjesëmarrja e grave	13
F.	Personat me aftësi të kufizuara.....	13
G.	Votimi, numërimi dhe rezultatet	13
H.	Drejtësia zgjedhore.....	14
V.	Tryeza e rrumbullakët e palëve të interesuara	15
VI.	Përfundimet.....	16
Anekset		
A.	Matrica mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të EOM-së.....	18
B.	Komunikatë për shtyp	27

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

MISIONI PËRCJELLËS I BE-SË PËR ZGJEDHJET NË KOSOVË

14 Nëntor – 8 Dhjetor 2022

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Një mision përcjellës i BE-së për zgjedhjet (EFM) u vendos në Kosovë nga data 14 nëntor deri më 8 dhjetor 2022. Qëllimet kryesore të misionit ishin që të vlerësojë statusin e zbatimit të rekomandimeve të Misioneve të BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve (EOM) si dhe për të diskutuar hapat e mëtejshëm për avancimin e procesit të reformës zgjedhore. Ky ishte misioni i parë i tillë i BE-së i vendosur ndonjëherë në Kosovë.

Që nga viti 2013, BE-ja ka vëzhguar të gjitha zgjedhjet në Kosovë dhe ka dhënë një sërë rekomandimesh për përmirësime në kornizën zgjedhore. Megjithatë, deri më tani, duket se nuk ka pasur ndonjë përparim të dukshëm në zbatimin e këtyre rekomandimeve, pjesërisht për shkak të mungesës së vullnetit politik për të vazhduar me një proces efikas përcjellës, e po ashtu për shkak të koalicioneve të paqëndrueshme qeverisëse dhe mbajtjes së shpeshtë të zgjedhjeve të parakohshme në Kosovë.

EU EOM në vitin 2021 propozoi 23 rekomandime, duke përfshirë gjashtë me prioritet, të cilat adresonin çështjet që ishin vërejtur gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 për kuvendet komunale dhe për kryetarë të komunave. Megjithatë, meqenëse mangësi të ngjashme afatgjatë ishin vërejtur edhe nga misionet e mëparshme vëzhguese të BE-së, shumë nga rekomandimet e vitit 2021 janë të ngjashme me ato që janë dhënë nga misionet e mëparshme. EFM u fokusua në zbatimin e rekomandimeve të vitit 2021.

Ndonëse shumica dërrmuese e rekomandimeve të BE-së ende nuk janë zbatuar,¹ EFM vërejt një përparim të rëndësishëm në adresimin e rekomandimeve të BE-së në fushën e financimit të fushatës. Disa rekomandime të tjera që kërkojnë ndryshimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) janë duke u shqyrtuar aktualisht dhe duket se ekziston një konsensus i gjerë mes ligjvënësve për t'i adresuar ato sa më shpejt. Procesi i reformës zgjedhore mbështetet edhe nga komuniteti i donatorëve, përfshirë Zyrën e PSBE-së, e cila ofron platformë për koordinimin e asistencës ndërkombëtare për zgjedhjet dhe bashkëfinancon një projekt të vogël në lidhje me këtë. Rekomandimet e EU EOM-së shërbejnë si referencë kryesore në këto përpjekje.

Në korrik të vitit 2022 Kuvendi i Kosovës (KK) krijoi një *Komision Ad Hoc për Reformën Zgjedhore* (në tekstin e mëtejshëm “Komisioni Ad Hoc”) për ndryshimin e legjisllacionit zgjedhor me mandat specifik për të adresuar rekomandimet e EU EOM-së të vitit 2021. Vullneti i mirëfilltë politik nga të gjitha grupet parlamentare për miratimin e reformave u konfirmua nga pothuajse të gjithë bashkëbiseduesit e EFM-së. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile shprehën pakënaqësinë e tyre në lidhje me shtrirjen e reformave të planifikuara pasi ato do të fokusohen kryesisht në adresimin e rekomandimeve të BE-së, të cilat të gjitha kanë të bëjnë me çështje teknike duke mos adresuar kështu shqetësimet e kahershme të shoqërisë civile që do të kërkonin ndryshime kushtetuese, si p.sh. zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit të Kosovës,

¹ Matrica me statusin e zbatimit të rekomandimeve të BE-së është e bashkangjitur në Aneksin 1.

numri i votave preferenciale për deputetët e Kuvendit të Kosovës ose aplikimi i përbërjes jopartiake të organeve për administrimin e zgjedhjeve.² Në të njëjtën kohë, Komisioni Ad Hoc shprehu dëshirën që të gjitha palët e interesuara të përfshihen në procesin e reformës.

Pas zgjedhjeve komunale të vitit 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka rishikuar një numër të madh të rregullave të tij me qëllim që të përfshijë në to rekomandimet e EU EOM-së 2021; tani ato janë në pritje të miratimit nga anëtarët e KQZ-së, që është planifikuar të bëhet kah mesi i dhjetorit 2022. Paralelisht me këtë, Komisioni i ka dhënë sugjerime Komisionit Ad Hoc për ndryshimet që duhet të bëhen në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Falë këtyre përpjekjeve, zbatimi i shumë prej rekomandimeve të EOM-së të vitit 2021 mund të konsiderohet nga EFM se është në vazhdim e sipër. Rekomandimet e tjera, përfshirë ato për regjistrimin e votuesve, mediat dhe mjedisin e fushatës ende nuk janë adresuar.

Procesi i reformës zgjedhore që sapo ka filluar në Kuvendin e Kosovës jep arsye për optimizëm të kujdesshëm lidhur me perspektivën e zbatimit të shumë rekomandimeve të BE-së para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare të planifikuara për vitin 2025. Ekziston një koalicion i qëndrueshëm qeverisës dhe një konsensus i gjerë midis palëve të interesuara mbi nevojën që më në fund të adresohen rekomandimet zgjedhore të BE-së.

EFM u bëri thirrje të gjitha palëve të interesuara që ta zhvillojnë këtë proces në mënyrë transparente dhe përfshirëse në mënyrë që elektorati të ketë besim në rezultatin e tij. Misioni i EFM-së u zhvillua në kohën e një krize në marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe komunitetit serb që jeton në katër komunat veriore, pas së cilës përfaqësuesit serbë kishin dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre në institucionet e Kosovës dhe, si rezultat, nuk morën pjesë në procesin e reformës zgjedhore që është duke u zhvilluar.

II. INFORMACION RRETH MISIONIT

Një mision përcjellës i zgjedhjeve i BE-së u vendos në Kosovë nga 14 nëntori deri më 8 dhjetor 2022. Misioni u drejtua nga z. Lukas Mandl, deputet i Parlamentit Evropian dhe Shef i Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë në vitin 2021. Krahas Shefit të Misionit, EFM përfshinte edhe dy ekspertë të zgjedhjeve dhe dy zyrtarë të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm.

Objektivat kryesore të EU EFM-së ishin vlerësimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve të EU EOM 2021 si dhe diskutimi i hapave të mëtejshëm për avancimin e procesit të reformës zgjedhore. Ky ishte EFM i parë i vendosur në Kosovë.

² Ndër të tjera, disa aktorë të shoqërisë civile avokojnë për aplikimin e identifikimit biometrik të votuesve dhe aplikimin e njësisve zgjedhore rajonale në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Si rregull, EU EOM-të nuk japin rekomandime për përdorimin e pajisjeve të TI-së në mbajtjen e zgjedhjeve ose për dizajnin e sistemeve zgjedhore, përveç nëse ato bien ndesh me standardet ndërkombëtare. Si të tilla, rekomandimet për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit të Kosovës ose për mënyrën e zgjedhjes së deputetëve të Kuvendit të Kosovës bien jashtë asaj që mund të rekomandojë një mision i BE-së sipas metodologjisë dhe mandatit të tij për vëzhgimin e zgjedhjeve.

III. KONTEKSTI

Prej nënshkrimit të marrëveshjes së ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet qeverive të Serbisë dhe Kosovës në vitin 2013 (Marrëveshja e Brukselit), BE-ja ka vëzhguar të gjitha zgjedhjet në Kosovë dhe ka dhënë një numër rekomandimesh për përmirësime në procesin zgjedhor, shumë prej të cilave përsëriten në të gjitha zgjedhjet. Megjithatë, deri më tani, nuk ka mund të vërehet asnjë përpjekje përcjellëse efikase për të marrë parasysh rekomandimet e BE-së. Mungesa e progresit në zbatimin e rekomandimeve të BE-së ishte rezultat i mungesës së vullnetit politik për të vazhduar reformën zgjedhore për adresimin e mangësive të kahershme, si dhe për shkak të koalicioneve të paqëndrueshme qeverisëse dhe mbajtjes së shpeshtë të zgjedhjeve të parakohshme që nuk mundësuan ndryshimin e legjislacionit zgjedhor nga Kuvendi i Kosovës.

EU EOM 2021 propozoi 23 rekomandime, duke përfshirë gjashtë me prioritet, që adresonin çështjet e vrojtura gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 për kuvendet komunale dhe për kryetarë të komunave. Çështje të ngjashme dhe afatgjate janë vërejtur edhe nga EU EOM-të e mëhershme, kështu që shumë prej rekomandimeve të vitit 2021 janë të ngjashme me rekomandimet e dhëna nga misionet e mëparshme, për shembull mbi regjistrimin e votuesve ose financimin e fushatës. EFM u përqendrua në zbatimin e rekomandimeve të vitit 2021, të cilat gjithashtu adresojnë të metat më të rëndësishme të identifikuar më herët dhe që janë ende.

A. ZHVILLIMET NË LIDHJE ME ZGJEDHJET

Komisioni Ad Hoc u formua më 1 korrik 2022 nga Kuvendi i Kosovës. Nën kryesimin e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK) opozitare dhe i përbërë nga të gjitha Grupet Parlamentare,³ mandati kryesor i Komitetit është të propozojë projektligje që përfshijnë rekomandimet e EU EOM-së të vitit 2021. Përveç kësaj, Komisioni vendosi të shqyrtojë edhe rekomandimet e palëve të tjera të interesuara, kryesisht të Misionit të Ekspertëve të Zgjedhjeve të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, të cilët nuk propozojnë ndryshime në sistemin zgjedhor ose në përbërjen e Kuvendit të Kosovës.

Pas diskutimeve mbi modalitetet operacionale gjatë muajve të parë të punës së tij, Komisioni Ad Hoc u thellua në përmbajtjen e reformave gjatë një seminari të mbajtur më 26 tetor 2022, i mbështetur nga PSBE dhe ku morën pjesë KQZ-ja dhe organizatat e shoqërisë civile. Një tjetër seminar i përbashkët këtij Komisioni me KQZ-në dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, i mbështetur nga OSBE-ja, u mbajt me 3 nëntor. Siç ka informuar EFM-në, Komisioni synon që deri në mesin e shkurtit të vitit 2023 ta dorëzojë në Kuvendin e Kosovës një projektligj për lexim të parë. Anëtarët e Komisionit Ad Hoc nga të gjitha Grupet Parlamentare, të cilët u takuan me EU EFM-në⁴, përsëritën se ekziston konsensusi ndërpartiak për të çuar përpara reformat. Ata po ashtu e theksuan vullnetin e fortë politik për të inkorporuar rekomandimet e EU EOM-së të vitit 2021, të cilat ata të gjithë i konsiderojnë si të paanshme dhe të nevojshme, në ligj në mënyrë që të rritet besueshmëria e procesit zgjedhor.

³ Komisioni Ad Hoc për Reformën Zgjedhore përbëhet nga 11 anëtarë, duke përfshirë pesë nga partitë opozitare, katër nga *Lëvizja Vetëvendosje* (LVV) në qeveri, një nga komunitetet joshumicë dhe një përfaqësues i *Srpska Lista* (SL). Siç tregohet në deklaratën e përbashkët të krerëve të grupeve parlamentare të datës 13 prill 2022 për krijimin e Komisionit Ad Hoc, përfaqësimi i grupeve parlamentare në Komision pasqyron fuqinë e tyre politike në Kuvend, në përputhje me rregulloren e Kuvendit.

⁴ EFM nuk ishte në gjendje të takonte përfaqësuesit e *Srpska Lista*.

Edhe pse e pranuan dinamikën ekzistuese për miratimin e rekomandimeve të EU EOM 2021, organizatat e shoqërisë civile me të cilat u takua EFM kritikuan vendimin e Komisionit Ad Hoc për të ngushtuar fushëveprimin e tij për t'u fokusuar vetëm në rekomandimet teknike në vend që të vazhdojë me një reformë të gjerë zgjedhore e cila do të kërkonte ndryshime kushtetuese. Arsytimi i Komisionit për këtë qasje “pragmatike” ndaj reformës nuk ishte vetëm mungesa e bashkëpunimit me deputetët e SL-së në Kuvendin e Kosovës, mbështetja e të cilëve do të ishte e domosdoshme për ndryshimet kushtetuese, por edhe se fillimi i diskutimeve për këto çështje do të ishte me polemika dhe rrjedhimisht i gjatë.

Organizatat e shoqërisë civile informuan EFM-në se po planifikonin të parashtronin, në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në Grupin Këshillues të Komisionit, disa çështje për diskutim, si heqja e kushtit për heshtje parazgjedhore dhe nevoja për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave (duke zbatuar kështu sistemin ‘fiton ai që merr më së shumti vota’), kushtet për kandidatët e rinj dhe identifikimin biometrik të votuesve në ditën e zgjedhjeve. Megjithatë, gjatë vendosjes së misionit EFM, si Komisioni Ad Hoc ashtu edhe KQZ-ja theksuan se deri atëherë nuk kishin marrë asnjë rekomandim të strukturuar nga shoqëria civile.

Dy çështje të tjera përtej fushëveprimit të rekomandimeve të EU EOM-së sipas të gjitha gjasave do të përfshihen në diskutimet për të cilat duhet të gjendet konsensusi mes anëtarëve të Komisionit Ad Hoc. E para është ndarja e procesit të numërimit ndërmjet Këshillave të Vendvotimeve (KVV) dhe Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ). Sipas shumicës së bashkëbiseduesve të EFM-së, kjo do të eliminonte mospërputhjet e identifikuar gjatë të gjitha proceseve të mëparshme zgjedhore ndërmjet numrit të votave që marrin subjektet politike (Formulari i Përputhjes së Rezultateve – FPR) dhe numrit të votave preferenciale që marrin kandidatët e tyre (Formulari i Rezultateve të Kandidatëve – FRK). Sipas këtij propozimi, votat për partitë politike prapë do të numërohen në vendvotime, ndërsa votat e kandidatëve do të numërohen në KKZ gjatë një procesi që shfaqet në kamerë dhe në prani të gjerë të vëzhguesve.⁵ Duket se edhe anëtarët e KQZ-së do të mbështesin ndarjen e procesit të numërimit si zgjidhja më e mirë për të adresuar manipulimin e votave preferenciale gjatë numërimit, problem i cili u ngrit nga pothuajse të gjithë bashkëbiseduesit e EFM-së.

Çështja e dytë që do të kërkojë një marrëveshje ndërpartiake nëse futet në diskutimin e Komisionit Ad Hoc është propozimi për votim personal në ambasada/konsullata për votuesit jashtë Kosovës (VjK) së bashku me votimin me postë tashmë të parashikuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Përveç sigurimit që ambasadat e Kosovës të organizojnë votimin personalisht, LVV në pushtet dëshiron të përfshijë misionet diplomatike në mbledhjen e votave me postë jashtë Kosovës dhe dërgimin e tyre në Prishtinë për numërim. Përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe PDK-së me të cilët u takua EFM i konsiderojnë këto propozime joreale duke pasur parasysh numrin e kufizuar të ambasadave të Kosovës dhe numrin e madh të votuesve potencialë jashtë vendit. Për më tepër, ata gjithashtu shprehën shqetësimin se procesi i votimit personal jashtë Kosovës do të ishte më i cenueshëm ndaj manipulimeve. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu konsiderojnë se ka resurse dhe kapacitete të pamjaftueshme për të organizuar votimin në ambasada dhe numri i kufizuar i ambasadave të Kosovës do të kërkonte që votuesit të udhëtonin në distanca të gjata për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar.⁶

⁵ Prej të gjithë bashkëbiseduesve të EU EFM-së, përfaqësuesit e PDK-së e informuan EFM-në se partia e tyre nuk do të mbështesë organizimin e numërimit jashtë vendvotimeve, qëndrim me të cilin pajtohen edhe organizatat e shoqërisë civile.

⁶ Për shembull, në Shtetet e Bashkuara, Kosova ka një ambasadë në Uashington DC dhe dy konsullata në Nju Jork dhe Iowa.

Sidoqoftë, diskutimet e pritshme për ndryshime të mëtejshme në organizimin e votimit jashtë Kosovës, të cilat nuk u rekomanduan nga EU EOM, ka mundësi të politizojnë debatin dhe të vonojnë reformën e përgjithshme. Për më tepër, disa përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile ngritën çështjen e kriterëve të kualifikimit të votuesve jashtë Kosovës, përkatësisht që vetëm personat me dokumente identifikimi të vlefshme të Kosovës duhet të lejohen të votojnë, ose nevojën për votim jashtë Kosovës në zgjedhjet komunale (aktualisht ligji parasheh votimin jashtë Kosovës si në zgjedhjet e përgjithshme ashtu edhe në ato komunale).

Në një qasje të mirëpritur proaktive, në të njëjtën kohë me aktivitetet e Komisionit Ad Hoc, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nisi procedurën e rishikimit të shumicës së rregullave të tij, me qëllim që të përfshijë rekomandimet e EU EOM të vitit 2021 të cilat nuk kërkojnë ndryshime legislative dhe miratimit të tyre kah mesi i dhjetorit 2022. Paralelisht, ai i ka dhënë sugjerime Komisionit Ad Hoc për ndryshimet që duhet të bëhen në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Ndërkohë, KQZ po ashtu është duke i bërë ndryshimet në strukturën dhe funksionimin e saj si rezultat i ndryshimeve në Ligjin për Financimin e Partive Politike (LFPP) dhe në LZP.⁷ Rrjedhimisht, KQZ-ja është në proces të rishikimit të rregulloreve përkatëse. *Ligji nr. 08/L-122 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme* është një përmirësim domethënës në kuadrin e mëparshëm ligjor, duke adresuar disa shqetësime të ngritura nga BE, Komisioni i Venedikut dhe shoqëria civile, megjithëse disa çështje të rëndësishme mbeten ende të pazgjidhura (*shih më poshtë rekomandimet për financimin e fushatës*).

B. KONTEKSTI POLITIK

Misioni Përcjellës i Zgjedhjeve u zhvillua në mes të krizës në marrëdhëniet ndërmjet Prishtinës dhe komunitetit serb që jeton në katër komunat veriore. Më 1 nëntor, autoritetet e Kosovës filluan të zbatojnë ndalimin e targave të regjistrimit të makinave të lëshuara nga Serbia (të ashtuquajturat targa KM) dhe kërcënuan me shqiptimin e gjobave të rënda për ata që nuk do të respektonin ligjin. Popullsia serbe protestoi kundër kësaj mase dhe pothuajse të gjithë përfaqësuesit serbë në shenjë proteste dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre të zgjedhura apo të emëruara në institucione të ndryshme të Kosovës, përfshirë Kuvendin e Kosovës, gjyqësorin dhe policinë. Kjo *de facto* e ktheu procesin e integritimit në situatën para Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013.

Ndonëse me 23 nëntor nën kujdesin e BE-së u arrit një marrëveshje për shtyrjen e zbatimit të rregulloreve për regjistrimin e veturave, zyrtarët serbë refuzuan të kthehen në funksionet e tyre të mëparshme derisa të krijohet asociacioni i komunave serbe në Kosovë në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit.

Mospjesëmarrja e ligjvënësve të *Lista Srpska* në punën e Kuvendit të Kosovës do të thotë gjithashtu se asnjë përfaqësues i komunitetit serb nuk merr pjesë në diskutimet e Komisionit Ad Hoc për reformën zgjedhore.

Pas dorëheqjes së kryetarëve serbë në katër komunat veriore si dhe këshilltarëve komunalë, presidenti i Kosovës i shpalli zgjedhjet e parakohshme për kryetarë të komunave në këto katër komuna për datën 18 dhjetor dhe zgjedhjet për këshilltarë komunalë në Zvečan dhe Leposaviç për 25 dhjetor. Përfaqësuesit politikë të popullatës serbe shpallën bojkotin. Pas "vlerësimit të

⁷ Ligji nr. 08/L-122, i cili e ka ndryshuar dhe plotësuar Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, është publikuar në gazetën zyrtare më 5 shtator 2022.

gjendjes së sigurisë në veri nga institucione kompetente”,⁸ zgjedhjet e parakohshme u desh të shtyheshin.

C. VEPRIMET E BE-SË PËR MISIONIN PËRCJELLËS TË EOM-SË

Bashkimi Evropian ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në mbështetjen e të gjitha institucioneve kryesore demokratike në Kosovë, përfshirë Kuvendin e Kosovës dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe organizatat e shoqërisë civile të përfshira në vëzhgimin e zgjedhjeve. Përfaqësuesi Special i BE-së/Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë e koordinon asistencën zgjedhore me shtetet anëtare të BE-së dhe me komunitetin e gjerë të donatorëve përmes takimeve dymujore të organizuara nga Zyra e PSBE-së. Në tetor u mbajt një seminar nikoqir i të cilit ishte PSBE-ja dhe që ishte bashkëorganizuar me Komisionin Ad Hoc. PSBE prezantoi rekomandimet e EU EOM-së që kërkonin ndryshime legjislative të ndara sipas grupeve tematike. Përfaqësuesit e PSBE-së marrin pjesë rregullisht në takime të ndryshme lidhur me zgjedhjet, duke përfshirë punëtoritë tematike të cilat u organizuan kohëve të fundit nga Komisioni Ad Hoc ku ata prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e EU EOM-ve.

Në vitet e fundit, ndihma e BE-së për zgjedhjet është kanalizuar kryesisht përmes një projekti të financuar nga BE për përcjelljen e vëzhgimit të zgjedhjeve në Ballkanin Perëndimor, i zbatuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Zyrën e Evropës për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (OSBE/ODIHR).

Pas zgjedhjeve komunale të vitit 2021, OSBE/ODIHR *ndër të tjera* i paraqiti KQZ-së një rishikim gjithëpërfshirës të njëmbëdhjetë rregullave të saj⁹ dhe hartoi tri “dokumente teknike” – mbi verifikimin e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidatëve përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me votuesit, mbi pjesëmarrjen e të miturve në fushatat zgjedhore dhe mbi kornizën normative dhe parimet për përdorimin e të miturve në reklamat politike. Ajo gjithashtu përgatiti një rishikim krahasues të kuadrit ligjor dhe praktikave në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së në lidhje me modalitetet e mbajtjes së zgjedhjeve lokale.

IV. STATUSI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË EOM-SË

A. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

LZP përfshin disa garanci për pavarësinë dhe transparencën në funksionimin e KQZ-së dhe dispozita që sigurojnë që anëtarët e saj nuk mund të hiqen për një lëshim të vogël, duke ulur kështu mundësinë për ndërhyrje politike. Megjithatë, formulimi i paqartë i paragrafit (d) të nenit 61.5 të LZP-së që lejon largimin e kryetarit ose një anëtarë nëse ata sillen ose veprojnë “në atë mënyrë që e dëmton seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së”, nuk është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare të cilat përcaktojnë se arsyet për largim duhet

⁸ Shih <https://president-ksgov.net/en/news/president-osmani-sets-april-23-2023-as-the-new-date-for-the-holding-of-the-early-elections-for-komuna-mitrovica-veri-zubin-potok-leposaviq-dhe-zvecan>

⁹ Rregullat e KQZ-së ishin për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike; Krijimin, konfirmimin dhe kontestimin e listës së votuesve; Votimin jashtë Kosovës; Votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta; Certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre; Raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave; Kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre; zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme; Periudhën e shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrës së votimit; dhe për Këshillat e vendvotimeve.

të jenë “të përcaktuara qartë dhe në mënyrë kufizuese në ligj.”¹⁰ Prandaj, rekomandimi i parë i EU EOM-së në vitin 2021 lidhur me administrimin e zgjedhjeve sugjeronte që **të ndryshohet LZP për të përshkruar në mënyrë të qartë dhe kufizuese arsyet për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të KQZ-së (Rek. Nr.1)**. Shoqëria civile dhe anëtarët e Komisionit Ad Hoc u takuan me EU EFM-në dhe e përsëritën aprovimin e tyre për këtë rekomandim, duke theksuar nevojën që ai të përfshihet në reformën zgjedhore. Duke qenë se zbatimi i këtij rekomandimi kërkon ndryshim të LZP-së, ai nuk mund të vlerësohet para se të finalizohet procesi i reformës.

EU EOM 2021 e ka përmendur në Raportin e tij Përfundimtar se KQZ-ja, pas raundit të parë të zgjedhjeve komunale, zëvendësoi 806 anëtarë të KVV-ve kryesisht për shkak të performancës së dobët gjatë numërimit dhe pasaktësive në plotësimin e formularëve të rezultateve. Kjo u vërtetua edhe nga numri i lartë i rinumërimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Për këtë arsye, EU EOM 2021 rekomandoi që të krijohet një pozitë administrative jopartiake e sekretarit të KVV-së për t’i ofruar KVV-së këshillat dhe asistencën e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën e tyre. Anëtarët e Komisionit Ad Hoc që u takuan me EFM-në shprehën konsensusin e tyre. Megjithatë, zbatimi i këtij rekomandimi konsiderohet nga Sekretariati i KQZ-së si i vështirë për shkak të vështirësisë për identifikimin e personave pa përkatësi politike, veçanërisht në viset rurale, të cilët do të pranoheshin nga të gjithë anëtarët e subjekteve politike në Këshillat e Vendvotimeve. Përveç kësaj, nëse ndryshohet ligji për të ndarë numërimin e votave ndërmjet KVV-ve dhe KKZ-ve, bashkëbiseduesit e EFM-së konsiderojnë se nuk do të kishte më nevojë për një pozitë të tillë. Ashtu si me rekomandimin e mëparshëm, edhe ky kërkon ndryshimin e LZP-së. Prandaj, është shumë herët për të vlerësuar zbatimin e tij. Në rekomandimet e saj për Komisionin Ad Hoc të diskutuar më 3 nëntor, KQZ propozoi që kjo çështje të diskutohej gjatë procesit të reformës dhe të parashihej pozita e sekretarit të KVV-së. Ai gjithashtu propozoi që pozita e kryesuesit të KVV-së të jetë pozitë jopartiake, e ngjashme me rolin e kryetarëve të KQZ-së dhe KKZ-ve, që ata të zgjidhen nga radhët e mësimdhënësve apo punonjësve të administratës komunale.

Rekomandimi nr.3 i EU EOM-së drejtuar KQZ-së nuk kërkon ndryshim ligjor. **Ai sugjeron tu jepën më shumë përgjegjësi KKZ-ve lidhur me edukimin dhe informimin e votuesve si dhe angazhimin e organizatave të shoqërisë civile në mbarë Kosovën. Duhet të adresohen grupe të veçanta të synuara, si gratë, votuesit në viset rurale, votuesit për herë të parë dhe personat me aftësi të kufizuara.** Ky rekomandim bazohej jo vetëm në faktin se të gjithë bashkëbiseduesit e EOM-së i konsideronin aktivitetet e edukimit të votuesve në viset rurale si të pamjaftueshme dhe rolin e KKZ-ve si shumë të kufizuar, por edhe për shkak se neni 107.3 i LZP-së udhëzon KQZ-në gjatë zhvillimit të fushatës për edukimin e zgjedhësve që “t’i kushtojë vëmendje të veçantë votuesve në viset rurale, me aftësi të kufizuara dhe analfabetë”. Anëtarët e KQZ-së informuan EU EFM-në se janë në proces të shqyrtimit të mundësive për t’u dhënë më shumë përgjegjësi KKZ-ve dhe jo vetëm në edukimin e votuesve, në mënyrë që ato të mbeten aktive edhe jashtë periudhave zgjedhore; megjithatë, ata përmendën buxhetin e kufizuar që përbën problemin kryesor për aktivitetet e edukimit të votuesve. Bazuar në atë që u tha më sipër, zbatimi i këtij rekomandimi është në vazhdim e sipër.

B. E DREJTA E VOTËS DHE REGJISTRIMI I VOTUESVE

Meqë Lista përfundimtare e votuesve në Kosovë bazohet në ekstrakte të Agjencisë për Regjistrimin Civil (ARC), fakti që ekstraktet që ARC i ka ofruar KQZ-së vijnë nga databaza e

¹⁰ Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, 2002, pika 3.1f.

dokumente të lëshuara të identifikimit, e cila përfshin edhe personat e vdekur dokumenti i identifikimit të të cilëve është ende i vlefshëm, ose personat që kanë hequr dorë nga shtetësia, por që ende posedojnë letërnjoftimet e tyre, në vend të bazës së të dhënave të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile i cili i paraqet personat që kanë vdekur, çon në pasaktësi. Këto probleme janë raportuar nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së që nga viti 2013.

Përfaqësuesit e Agjencisë së Regjistrimit Civil informuan EFM-në se ka pasur pak progres në lidhje me zbatimin e rekomandimit të EU EOM-së për **aplikimin e një mekanizmi për heqjen automatike të personave të vdekur nga regjistri civil dhe nga baza e të dhënave të dokumenteve të lëshuara të identifikimit sapo ARC të ketë marrë informacion nga spitalet dhe institucionet fetare (Rek. Nr.4)**. Ndryshimi i vetëm deri më tani është se është përmirësuar bashkëpunimi i tyre me institucionet fetare për raportimin e vdekjeve.

Një problem tjetër me saktësinë e listave të votuesve lidhet me adresat e votuesve. Sipas bashkëbiseduesve të EFM-së, për shkak se listat e votuesve bazohen në bazën e të dhënave të letërnjoftimeve që u janë lëshuar qytetarëve, kur votuesit ndryshojnë adresën e vendbanimit pa aplikuar për letërnjoftim të ri, adresa e tyre e mëparshme ende identifikohet në listat e votuesve dhe votuesit e tillë caktohen në vendvotimet e vendbanimit të tyre të mëparshëm. Për më tepër, bazat e të dhënave të ARC-së dhe të Agjencisë Kadastrale nuk janë të unifikuara dhe disa adresa dhe numra rrugësh janë të pasakta, të shkruara ndryshe etj. Prandaj, EOM e vitit 2021 rekomandoi që të **përshejtohet zhvillimi i një sistemi unik të adresave për ta bërë më të saktë caktimin e votuesve në vendet e votimit (Rek. Nr.5)**. Megjithatë, nuk është arritur ndonjë përparim domethënës në këtë drejtim. Vitin e kaluar, ARC-ja filloi së bashku me Agjencinë Kadastrale një pilot projekt në dy komuna lidhur me zhvillimin e një sistemi unik të adresave.¹¹ Projekti pritet të përfundohet brenda gjashtë muajve dhe pastaj gradualisht të zgjerohet në të gjitha komunat e Kosovës. Megjithatë, është e paqartë se kur do të mund të krijohet përfundimisht sistemi unik i adresave në mbarë Kosovën.

Disa përfaqësues të shoqërisë civile dhe opozitës sugjerojnë një përfshirje më aktive të KQZ-së në menaxhimin e listave të votuesve, për shembull në heqjen e të dhënave të personave të vdekur nga baza e të dhënave të marra nga ARC para mbajtjes së zgjedhjeve. Megjithatë, është e paqartë se si kjo mund të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme pasi të njëjtat gabime nga baza e të dhënave të ARC-së ka mundësi të rishfaqen në listat e votuesve para zgjedhjeve të tjera.

EOM 2021 vuri në dukje se procesit të regjistrimit dhe verifikimit të votuesve jashtë Kosovës i mungonin garancitë thelbësore për të mbrojtur integritetin e tij nga manipulimi dhe mashtrimi dhe rekomandoi që të **modernizohet metoda e regjistrimit si votues jashtë Kosovës, për shembull, përmes një vegëze në faqen e internetit të KQZ-së me masa të sigurisë siç është verifikimi me dy faza i aplikuesve (Rek. prioritar Nr. 6)**.

Anëtarët e Komisionit Ad Hoc nga PDK, LDK dhe LVV e informuan EFM-në se e mbështesin plotësisht rekomandimin e EU EOM-së në vitin 2021 që KQZ-ja të krijojë një sistem të aplikimit online për votuesit jashtë Kosovës. KQZ-ja informoi EFM-në se aktualisht, me mbështetjen e OSBE-së, është duke zhvilluar një aplikacion softuerik me verifikim dy faktorësh, që do të përfundojë deri në qershor 2023. Votuesit jashtë Kosovës do të aplikojnë për regjistrim përmes një aplikacioni në faqen e internetit të KQZ-së dhe aplikimet me faks më nuk do të aprovohen. Gjithashtu, me qëllim të rritjes së mëtejshme të besueshmërisë së procesit, KQZ-ja do të lejojë çdo votues jashtë Kosovës të dërgojë vetëm një zarf në KQZ dhe jo që një zarf të ketë brenda fletëvotimet e disa votuesve. Si i tillë, ky rekomandim pothuajse është zbatuar.

¹¹ Pilot projekti i financuar nga Banka Botërore zbatohet në Mitrovicën e Jugut dhe Istog.

C. PARTITË POLITIKE, FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATA ZGJEDHORE

Siç kërkohet nga LZP, KQZ-ja kërkon verifikimin e evidencës penale të të gjithë kandidatëve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), i cili menaxhon Sistemin qendror të evidencës penale të Kosovës. EU EOM 2021 vërejtë se ky hap kyç procedural nxori në pah disa mangësi, pasi në disa raste informacioni mbi evidencën penale mbërriti me vonesë ose nuk iu transmetua fare KQZ-së. Prandaj rekomandohet që të **sigurohet se ekziston një mekanizëm për transmetimin e saktë dhe me kohë të të dhënave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për t'i mundësuar KQZ-së të bëjë një verifikim efikas dhe të besueshëm të evidencës penale të kandidatëve (Rek. Nr.7)**. Ky rekomandim, i cili nuk kërkon ndonjë ndryshim ligjor, ende nuk është zbatuar.

Gjatë zgjedhjeve komunale të vitit 2021, bazuar në LZP, KQZ-ja përjashtoi 176 kandidatë për shkak të dosjeve të tyre penale në tri vitet e fundit.¹² Kjo dispozitë ligjore është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare pasi shpërfill peshën e krimit dhe në të kaluarën ka qenë burim i interpretimeve të ndryshme pasi që nuk është as në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe Kodit Penal. Si rezultat, EU EOM 2021 rekomandoi që të **përcaktohet në ligjin për zgjedhjet se një kandidat e humb të drejtën për tu kandiduar vetëm nëse ka një dënim penal të formës së prerë për vepra të rënda penale dhe në bazë të një vendimi gjyqësor që i heq shprehimisht një personi të dënuar të drejtën për tu kandiduar (Rek. nr. 8)**. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon ndryshim të nenit 29 të LZP-së. Si të tillë, bashkëbiseduesit e shoqërisë civile shprehën shqetësimin e tyre se zbatimi i këtij rekomandimi mund të jetë shumë i vështirë për shkak të mospajtimeve të mundshme ndërmjet partive politike. Megjithatë, KQZ-ja në rekomandimet e saj drejtuar Komisionit Ad Hoc, sugjeroi që të diskutohet për këtë çështje specifike.

Vetëm një nga rekomandimet e EOM-së 2021 ka të bëjë me mjedisin e fushatës (**Rek.nr.9**). Fushata e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave filloi zyrtarisht më 8 nëntor dhe zgjati vetëm pesë ditë, deri më 12 nëntor, në përputhje me vendimin përkatës të KQZ-së.¹³ Meqë korniza ligjore nuk përcakton ndonjë ndëshkim për zhvillim të fushatës jashtë kësaj periudhe dhe KQZ-ja nuk ndërmoi asnjë masë,¹⁴ EU EOM 2021 gjeti se shumica e garuesve rifilluan aktivitetet e tyre të fushatës menjëherë pas raundit të parë, veçanërisht në mediat sociale, duke mos respektuar periudhën zyrtare 5-ditore të fushatës. Rrjedhimisht, EOM sugjeroi që të **aplikohen masa për të zbatuar kufizimet e periudhës zyrtare të fushatës për raundin e dytë të zgjedhjeve ose të lejohet që fushata të fillojë menjëherë pas raundit të parë**. Një rekomandim i tillë kërkon ndryshimin e rregullës zgjedhore të KQZ-së dhe bërjen e ndryshimeve në Ligjin për Zgjedhjet Lokale. Nuk është raportuar progres në zbatimin e tij, edhe për faktin se reforma zgjedhore fokusohet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Ndoshta progresi më i rëndësishëm në zbatimin e rekomandimeve të BE-së për zgjedhjet është arritur në fushën e financimit të partive politike dhe fushatave. Kuvendi i Kosovës miratoi në gusht të vitit 2022 Ligjin nr. 08/L-122, i cili ndryshoi dhe plotësoi Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke adresuar kështu pjesërisht dy rekomandimet e bëra nga EU EOM 2021.

¹² LZP, neni 29.1.q “një person i shpallur fajtor për (çdo) veprë penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit” nuk ka të drejtë të kandidojë.

¹³ Megjithatë, ky vendim i KQZ-së nuk ishte harmonizuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i cili përcakton një periudhë të heshtjes zgjedhore prej 24 orësh para hapjes së vendotimeve në orën 7.00. Si rezultat, u vërejt zhvillimi i fushatës në platformat online edhe pak para orës 7.00 të datës 13 nëntor.

¹⁴ Sipas nenit 126 të LZP-së, KQZ-ja mund të kishte nxjerrë një rregull që përcakton ndëshkime dhe gjopa për shkeljet e dispozitave të LZP-së.

Ligji i ri përfshin përmirësime të rëndësishme në dispozitat e mëparshme të zbatueshme për financimin politik dhe të fushatës dhe trajton kryesisht shqetësimet e ngritura nga Komisioni i Venedikut në Opinionin e tij përkatës.¹⁵ Janë miratuar dispozita të reja për të rritur transparencën e financimit të fushatës duke shtuar kërkesën për të publikuar listën e personave fizikë dhe juridikë që kontribuojnë në një subjekt politik dhe/ose për fushatë, si dhe për të parashikuar gjobat përkatëse për shkeljet e dispozitave të tij.

Duke identifikuar mungesën e mekanizmave efektivë zbatues për rregullat e financimit të fushatës që çoi në respektim të kufizuar në radhët e garuesve dhe, nga ana tjetër, në mungesë të qartë të transparencës dhe llogaridhënies, EU EOM 2021 dha një rekomandim me prioritet në fushën e financimit të fushatës (**Rek.nr.11**). Ai rekomandoi se duhet siguruar që të ketë një **mekanizëm të pavarur për mbikëqyrjen efektive të financimit të partive dhe fushatave, të cilit i jepet mandati, autoriteti, si dhe burimet financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe hetuar në mënyrë efektive dhe proaktive parregullsitë e pretenduara në financimin e partive dhe fushatave, përfshirë edhe të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara dhe shqiptimin e ndëshkimeve**. Në vijim të ndryshimeve të lartpërmendura legjislative, ligji parashikon reformimin e Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, tashmë e riemërtuar (në vijim: Zyra). Ajo i mban përgjegjësitë e Zyrës së mëparshme të Regjistrimit dhe Certifikimit të Partive Politike, siç parashikohet nga LZP, por gjithashtu i jepet një mandat dhe burime të forta për të monitoruar dhe audituar financat e subjekteve politike. Zyra ka një kompetencë të gjerë për të bërë mbikëqyrjen në çdo rast që vlerëson se një subjekt politik ka shkelur ligjin dhe mund të bëjë verifikimin e respektimit të rregullave për çdo parregullsi në lidhje me financimin e fushatës dhe raportimin, në përputhje me rekomandimin e EU EOM-së 2021.

Përveç kësaj, Zyra e reformuar, edhe pse e themeluar brenda strukturës së KQZ-së, duhet të gëzojë pavarësi operationale me burime adekuate administrative, financiare dhe njerëzore dhe të menaxhojë buxhetin e saj, i cili nuk mund të kufizohet apo rialokohet nga KQZ-ja ose kryetari i saj për asnjë qëllim pa miratimin e Drejtorit të Zyrës. Kjo është në përputhje me rekomandimin e EU EOM-së dhe me opinionin e lartpërmendur të Komisionit të Venedikut. Ligji i ri parashikon ndarjen vjetore të një buxheti shtesë për auditimin e financimit të partive politike prej jo më pak se pesë për qind nga Fondi për Mbështetjen e Partive Politike dhe gjatë ciklit zgjedhor jo më pak se tre për qind të mjeteve të ndara për fushatën dhe operationet zgjedhore. Kjo duhet të adresojë mungesën e fondeve të mjaftueshme për të kryer auditimet, që është identifikuar nga EU EOM 2021.

Zyra ishte themeluar që më 20 shtator 2022 dhe gjatë kohës së vendosjes së EFM-së, KQZ-ja po hartonte rregullat përkatëse, që pritej të miratoheshin deri në mars 2023 dhe ishte në proces të zgjedhjes së drejtorit të Zyrës, që pritet të përfundojë deri më 20 dhjetor. Ligji i ri ndryshoi mënyrën e zgjedhjes së drejtorit, i cili rekrutohet nga një panel pesë anëtarësh, i kryesuar nga Kryetari i KQZ-së dhe i përbërë nga anëtarë të agjencive/institucioneve të pavarura, pas shpalljes së konkursit publik.¹⁶ Ky është një përparim i rëndësishëm krahasuar me metodën e mëparshme të emërimit që parashikonte një përzgjedhje përmes një paneli intervistues të përbërë vetëm nga anëtarë të KQZ-së. Megjithatë, disa bashkëbisedues të EFM-së ngritën shqetësimet se kjo metodë e re e emërimit e ka bërë procesin më të cenueshëm ndaj ndikimit

¹⁵ Komisioni i Venedikut, Opinionin 922/2018 për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike.

¹⁶ Sipas ligjit të ri, përveç Kryetarit të KQZ-së, paneli përzgjedhës përbëhet nga një anëtar i emëruar nga secila prej agjencive/institucioneve të mëposhtme: Agjencia Kundër Korrupsionit, Institucioni i Avokatit të Popullit, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

politik pasi anëtarët e panelit përzgjedhës emërohen nga shumica parlamentare. Vlen të përmendet se kriteret e përzgjedhjes për postin e drejtorit të zyrës janë zgjeruar me ligjin e ri, i cili kërkon që drejtori të mos ketë qenë anëtar i një subjekti politik dhe as të ketë dhënë donacion apo të ketë qenë direkt apo indirekt në ndonjë marrëdhënie kontraktuese me një subjekt politik pesë vjet para paraqitjes së aplikacionit të tij/saj. Kjo është një qasje më e rreptë se sa në ligjin e mëparshëm (neni 66.3 LZP) që vetëm kërkonte që personi të mos ketë asnjë post zyrtar apo pozitë ekzekutive në një parti politike dhe është një hap pozitiv për të ruajtur më tej integritetin e drejtorit të zyrës.

Meqë *de facto* themelimi i Zyrës është ende në proces, zbatimi i këtij rekomandimi prioritar është në vazhdim e sipër, pasi kërkon jo vetëm ndryshime në ligj, por edhe aplikimin e tyre në mënyrë që të sigurohet transparenca e financimit të fushatës dhe integriteti i punës së institucioneve mbikëqyrëse. Prandaj, zbatimi përfundimisht do të varet nga efektiviteti i funksionimit të sistemit të ri, i cili mund të vlerësohet në të ardhmen.

Para këtyre ndryshimeve, afati i fundit për raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës ishte caktuar të jetë 45 ditë pas zgjedhjeve, duke kufizuar mundësinë e shqyrtimit publik para ditës së zgjedhjeve. Derisa shpenzimet e kandidatëve individualë mund të jenë të konsiderueshme, veçanërisht në garën për kryetar të komunës, atyre nuk u kërkohej të dorëzoheshin raporte të veçanta të fushatës dhe partitë në përgjithësi nuk i pasqyrojnë këto shpenzime në pasqyrat e tyre financiare. Përveç kësaj, derisa financimi i fushatës nga palët e treta mbetet i parregulluar, EU EOM 2021 vërejtë se afër një e treta e reklamave të fushatës që qarkullonin në Facebook dhe Instagram para raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave ishin sponsorizuar nga palë të treta. Prandaj, një rekomandim tjetër (**Rek.nr.10**) kërkon ndryshimin e LZP-së dhe LFPP-së në mënyrë që të **përcaktojë raportimin e ndërmjetëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës si dhe raportimin përfundimtar brenda 30 ditësh nga dita e zgjedhjeve, i cili duhet të përfshijë financimi i kandidatëve të emëruar nga partia dhe subjekteve që bëjnë fushatë për garuesit (palët e treta). Në fund, i njëjti rekomandim sugjeron që në ligj të përcaktohet një afat i shkurtër për autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet politike që të publikojnë të gjitha raportet financiare në mënyrë lehtësisht të kërkueshme.**

Zbatimi i këtij rekomandimi është i pjesshëm. Përderisa ligji i ri përcakton kërkesat për publikimin e raporteve financiare të fushatës dhe raporteve financiare tremujore dhe vjetore për subjektet politike, për kandidatët për kryetarë të komunave dhe për kandidatët e tjerë të pavarur, ai nuk i zgjeron këto kërkesa edhe për kandidatët individualë të nominuar nga partitë, kështu që nuk është plotësisht në përputhje me rekomandimin e EU EOM-së. Në mënyrë pozitive, ai shkurton afatin e autoriteteve mbikëqyrëse për publikimin e raporteve të auditimit të financimit të fushatës së subjekteve politike nga gjashtë muaj në 45 ditë pas zgjedhjeve, duke zbatuar kështu këtë pjesë të rekomandimit të EU EOM-së. Sidoqoftë, transparenca dhe llogaridhënia nuk mund të sigurohet siç duhet pa mbikëqyrjen e financimit të fushatës dhe shpenzimeve të kandidatëve individualë të emëruar nga partitë.

D. MEDIAT

EOM 2021 dha tri rekomandime në lidhje me mjedisin mediatik, duke përfshirë një prioritet (**Rek.nr.14**) për të emëruar me kohë të gjithë anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media (KPM) dhe Bordit të Ankesave të KPM-së. KPM-së i nevojitet kuorumi me të shtatë anëtarët për miratimin e vendimeve. Ndërkohë që Kuvendi i Kosovës ka bërë tri emërime të reja në KPM që nga përfundimi i zgjedhjeve të vitit 2021, kanë skaduar mandatet e anëtarëve të tjerë dhe Komisioni vazhdon të mbetet pa kuorum. Komisioni aktualisht përbëhet vetëm nga katër

anëtarë dhe i mungon udhëheqja pasi mandati i kryetarit dhe zëvendësit të tij ka skaduar në tetor 2022. Ngjashëm, janë emëruar vetëm dy nga tre anëtarët e Bordit të Ankesave duke mos mundësuar marrjen e vendimeve të cilat kërkojnë praninë e të tre anëtarëve. Si i tillë, ky rekomandim mbetet pa u zbatuar.

EOM-ja e vitit 2021 vuri në dukje se pavarësisht pluralizmit ekzistues në tregun mediatik, KPM-ja nuk zhvilloi një kornizë rregullative për të siguruar pluralizmin mediatik dhe për të parandaluar përqendrimin e mediave në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, KPM-ja jep informacione të kufizuara ose nuk jep fare informacione publike mbi pronësinë e transmetuesve të licencuar. Prandaj, në rekomandimin **nr. 13** EOM-ja sugjeroi **të krijohen dispozita specifike rregullative që synojnë sigurimin e pluralizmit mediatik dhe transparencës mbi pronësinë e medias**. Zyra e BE-së përmes projekteve të saj për media ka mbështetur zbatimin e këtij rekomandimi duke angazhuar dy ekspertë të cilët ndihmuan KPM-në për të hartuar një projekt-rregullorë për pronësinë e mediave. Pasi të plotësohen vendet e lira të mbetura të punës në KPM, Komisioni do të mund të shqyrtojë projekt-rregulloren dhe të nis procesin e konsultimit publik, siç kërkohet me ligj. Përndryshe, nëse do të kishte vullnet të mjaftueshëm politik në Kuvendin e Kosovës, kjo çështje shumë e ndjeshme do të mund të trajtohej edhe me një ligj të veçantë për pluralizmin mediatik. Zbatimi i këtij rekomandimi është në vazhdim e sipër.

Radiotelevizioni Publik i Kosovës (RTK) nuk është plotësisht i pavarur pasi financohet kryesisht nga buxheti i shtetit pa rregulla të qarta se si të përcaktojë buxhetin e tij vjetor, duke e bërë atë të cenueshëm ndaj ndikimit politik. EU EOM 2021 kishte raportuar se një projektligj që synon të rris pavarësinë financiare të RTK-së është shqyrtuar dhe diskutuar nga Kuvendi i Kosovës viteve të fundit, por nuk është miratuar asnjë herë. Si rezultat, EOM bëri thirrje që **të forcohet pavarësia e transmetuesit publik RTK nga ndërhyrjet e mundshme politike duke rishikuar sistemin e financimit të tij (Rek.nr.14)**. EFM nuk ishte në gjendje të identifikonte ndonjë progres në zbatimin e këtij rekomandimi. Përkundrazi, më 18 nëntor, bordi i RTK-së lëshoi një deklaratë shqetësuese se buxheti i saj i ndarë prej 8.96 milionë eurosh për vitin 2023, që është 2.2 milionë euro më pak se buxheti i vitit 2021, ishte joadekuat dhe “nuk do t’i mundësonte transmetuesit publik të bëjë ndonjë investim në pajisje apo teknologji të reja”.¹⁷

Lidhur me fushatën digjitale, EOM 2021 vuri në dukje se nuk kishte asnjë dispozitë ligjore për zhvillimin e fushatës në internet dhe shpërndarja e reklamave zgjedhore në platformat online po ashtu ishte e parregulluar. EOM 2021 kishte rekomanduar që **të përfshihen dispozita për reklamat zgjedhore në platformat online dhe që rregullat ekzistuese të fushatës të zgjerohen në mënyrë eksplicite për të mbuluar edhe sferën digjitale (Rek.nr.15)**. EFM nuk ishte në gjendje të identifikonte ndonjë progres në zbatimin e këtij rekomandimi.

EOM 2021 po ashtu vërejti se aplikimi i arkivave të reklamimit në mediat sociale do të mundësonte një shkallë të kontrollit të përmbajtjes me pagesë, në përputhje me standardet ndërkombëtare për transparencë dhe qasje në informacion. Si i tillë, rekomandimi i misionit **(Rek.nr.16)** bënte thirrje për **nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet administratës zgjedhore dhe ofruesve digjitalë për çështjet e reklamave zgjedhore online**. Ndërkohë që nuk u arrit asnjë përparim në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet KQZ-së dhe ofruesve digjitalë, në korrik të vitit 2022, Facebook-u filloi të aplikojë për Kosovën politikën e zbatimit të detyrueshëm të transparencës së reklamave politike, e cila përfshin kërkesat për shfaqjen e reklamave politike dhe mbajtjen e një biblioteke të këtyre reklamave për shtatë vjet.

¹⁷ Shih <https://balkaninsight.com/2022/11/18/kosovo-public-broadcaster-complains-of-smallest-ever-budget/>

E. Pjesëmarrja e Grave

Korniza legjislativë e Kosovës përfshin dispozita që promovojnë barazinë gjinore në jetën publike, përfshirë kuotën prej 30 për qind për certifikimin e subjekteve politike dhe për shpërndarjen e vendeve në asambljetë komunale dhe Kuvendin e Kosovës të përcaktuar nga LZP, dhe kuotën 50 për qind për të gjitha institucionet legjislativë, ekzekutive dhe publike, që kërkohet me Ligjin për Barazi Gjinore të vitit 2015. Megjithatë, përkundër këtyre masave mbrojtëse, EOM 2021 vërejti një numër shumë të ulët të grave kandidatë në garat për kryetare të komunave (8 për qind) dhe vetëm dy prej tyre u zgjedhën si kryetare të komunave, që të dyja përfaqësonin SL-në. Përfaqësueset e Rrjetit të Grave të Kosovës që u takuan me EFM-në avokojnë për harmonizimin e ligjeve për çështjet gjinore dhe ligjeve për zgjedhjet duke futur kuotën 50 për qind të kandidatëve për të gjitha zgjedhjet, por – sipas tyre – qeveria ende nuk është pajtuar me këtë.

Për të promovuar më tej barazinë gjinore, EOM 2021 rekomandoi që partitë politike ta marrin parasysh **miratimin e politikave të brendshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe integritimin e çështjeve gjinore në platformat e partive (Rek.nr.17)**. Derisa të gjitha partitë kryesore me të cilat u takua EFM raportuan përpjekje të vazhdueshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave si kandidatë dhe brenda strukturave partiake, disa shpallën vendime konkrete të politikave. PDK-ja ka miratuar të ashtuquajturin synim për përfaqësimin e grave 50/50 në të gjitha nivelet e organizimit dhe vendimmarrjes. LVV-ja në pushtet ka krijuar një grup autonom dhe të pavarur të "vetëvendosjes së grave" brenda strukturave të saj, i cili do të propozojë kandidatë (gra) për zgjedhjet e ardhshme, por pa ndonjë mekanizëm specifik të kuotës. Prandaj, zbatimi i rekomandimit nr. 17 është duke vazhduar.

F. Personat me aftësi të kufizuara

Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK), ajo e ka përfshirë përkufizimin e KDKPAK-së për aftësinë e kufizuar në Planin e saj Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar, i cili synon të harmonizojë legjislativën e Kosovës me KDKPAK-në dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare. Megjithatë, në mënyrë që të garantohen plotësisht të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, EU EOM 2021 rekomandoi që **në Kushtetutë të përfshihet dhe transpozohet KDKPAK e OKB-së, në mënyrë që të zbatohen të drejtat që garantohen në të (Rek.nr.18)**. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon ndryshim të kushtetutës, kështu që është e vështirë të zbatohet në fazën e tanishme. Transpozimi i KDKPAK-së së OKB-së në Kushtetutë është ende prioritet i komunitetit të personave me aftësi të kufizuar, sipas Forumit të Kosovës për Aftësinë e Kufizuar. Prandaj, Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në qershor të vitit 2022 inicioi një takim me deputetët e Kuvendit të Kosovës (KK) për ta diskutuar atë. Edhe pse anëtarët e KK-së shprehën qëndrimin se do të ishte vështirë të arrihet të bëhen ndryshimet kushtetuese për shkak të rrethanave ekzistuese politike, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara të Kosovës (OPAK) po planifikojnë që në vitin 2023 të formojnë një grup avokimi për të bërë fushatë për këtë ndryshim. Prandaj, është ende tepër herët për të vlerësuar zbatimin e këtij rekomandimi.

G. Votimi, Numërimi dhe Rezultatet

EU EOM 2021 dha tri rekomandime që synojnë përmirësimin e procesit të votimit, numërimit dhe tabelimit.

E para nga këto nuk kërkon ndonjë ndryshim ligjor ose rregullativ. Ai sugjeron të intensifikohet trajnimi i stafit zgjedhor për të adresuar mangësitë e përsëritura si mosrespektimi në mënyrë konsekuente i procedurave të numërimit të votave dhe plotësimi i gabuar i formularëve të rezultateve (Rek.nr.21). Është shumë herët të vlerësohet zbatimi i këtij rekomandimi, pasi trajnimi i stafit të votimit bëhet disa javë para ditës së zgjedhjeve.

Duke vënë në dukje se votimi i asistuar ishte regjistruar në librat e votimit në 70 për qind të vendvotimeve të vizituara, EU EOM rekomandoi më tej ndryshimin e LZP-së për të përcaktuar që votimi i asistuar në qendrat e votimit të rregullohet në mënyrë më të rreptë, për shembull duke kërkuar që personi që ndihmon një votues të jetë i regjistruar në të njëjtin vendvotim (Rek.nr.22). KQZ-ja analizoi çështjen e votimit të asistuar dhe në rekomandimet e saj për Komisionin Ad Hoc e mbështeti plotësisht rekomandimin e EU EOM-së, duke sugjeruar që personi që ndihmon duhet të jetë votues në të njëjtin vendvotim me votuesin që i duhet ndihma. Prandaj, nëse Komisioni Ad Hoc e miraton këtë sugjerim, ai do të zbatohet plotësisht rekomandimin përkatës të BE-së, por duke qenë se reforma është duke vazhduar, është shumë herët për ta vlerësuar atë. Gjithashtu, KQZ-ja propozon futjen e një dispozite të re që do ta bënte vepër penale asistimin e votuesve më shumë se një herë, duke synuar kështu të ruajë më tej procesin e votimit të asistuar nga manipulimi.

Gjatë zgjedhjeve komunale të vitit 2021, EU EOM analizoi të dhënat e ndara sipas komunave të publikuara nga KQZ-ja dhe konstatoi se numri i fletëvotimeve të pavlefshme në raundin e parë të zgjedhjeve për kryetar të komunës ishte 1.6 për qind. Në anën tjetër, numri i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet për kuvende komunale arriti në pothuajse 7 për qind, duke treguar kështu se ka pasur aktivitete të pamjaftueshme për informimin e votuesve dhe dizajn tepër të ndërlikuar të fletëvotimeve. Prandaj rekomandohet që të ridizajnohen fletëvotimet e zgjedhjeve për kuvendet komunale për tu kuptuar më mirë nga votuesit dhe të shtohen informacionet për votuesit se si të shënojnë si duhet fletëvotimin në mënyrë që të ulet numri i votave të pavlefshme (Rek. prioritar nr. 23). Për këtë nuk kërkohet ndryshim ligjor por vetëm vendim i KQZ-së. Anëtarët e KQZ-së informuan EFM-në se janë në proces të ridizajnimit të fletëvotimit për zgjedhjet parlamentare dhe aktualisht po kryejnë, gjatë ditëve të zgjedhjeve në shkollat e mesme, një test pilot të dy opsioneve të ndryshme, rezultatet e të cilave KQZ-ja planifikon t'i diskutojë me organizatat e shoqërisë civile përpara se të finalizojnë dizajnin e ri. Prandaj, zbatimi i këtij rekomandimi është duke vazhduar.

H. DREJTËSIA ZGJEDHORE

EU EOM 2021 vuri në dukje se kuadri ligjor për gjykimin e kontesteve zgjedhore përmban dispozita konfuze dhe kontradiktore në lidhje me afatet e caktuara për parashtrësia dhe ankesa. Sipas ligjit, parashtrësia dhe ankesat mund të dorëzohen brenda një afati prej 24-orësh në PZAP, i cili pastaj i ka 72 orë për të marrë vendim. Ankesa pastaj mund të parashtrë brenda 24 orësh në Gjykatën Supreme (GJS), shkalla përfundimtare, e cila ka 72 orë për të vendosur. Këto afate u vlerësuan nga të gjithë bashkëbiseduesit e EU EOM-së si jashtëzakonisht të shkurtra, si për palët për të mbledhur prova të forta ashtu edhe për organet e ankesës për t'i vlerësuar dhe shqyrtuar ato në mënyrë gjithëpërfshirëse. Prandaj EU EOM 2021 rekomandoi që të zgjaten afatet për paraqitjen e parashtrësive apo ankesave për zgjedhjet, dhe për PZAP dhe GJS-në për t'i gjykuar ato, në tri deri në pesë ditë (si për paraqitjen e parashtrësive dhe ankesave ashtu edhe për gjykimin e tyre (Rek. Nr.19). Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon ndryshimin e neneve përkatëse të LZP-së dhe më pas të rregullores së punës së PZAP-së. Prandaj, zbatimi i tij lidhet me punën e Komisionit Ad Hoc, e cila është duke vazhduar aktualisht, por nga takimet e zhvilluara me anëtarë të ndryshëm rezultoi se zgjatja e afateve,

qoftë për paraqitjen e ankesave, qoftë për gjykim apo për të dyja, nuk mbështetet nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Komision.

PZAP ka përgatitur një sërë rekomandimesh për Komisionin Ad Hoc që në përgjithësi janë në përputhje me rekomandimin e lartpërmendur dhe do ta zbatonte pjesërisht atë. Në veçanti, ai rekomandoi zgjatjen e afateve kohore për paraqitjen e parashtresave dhe ankesave lidhur me regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës në 48 orë (nga 24 orë sa është aktualisht në LZP) dhe për gjykim nga PZAP në 96 orë (në vend të 72 orëve sa është aktualisht). Ai rekomandoi më tej zgjatjen e afatit për parashtrimin e ankesave për parregullsi në ditën e zgjedhjeve në 48 orë pas mbylljes së vendvotimeve dhe që vendimi i PZAP-së të merret brenda 96 orëve (në vend të 72 orëve sa është aktualisht). Në fund, PZAP rekomandoi që afati për paraqitjen e ankesave kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të zgjatet në 48 orë dhe që PZAP të vendosë brenda 96 orësh. Prandaj, ky rekomandim i PZAP-së do të zbatonte pjesën e parë të rekomandimit të EU EOM-së të vitit 2021.

Veçanërisht, PZAP, bazuar në praktikat e zgjedhjeve të kaluara, konsideron se jo të gjitha afatet duhet të shtyhen. Prandaj i rekomandoi Komisionit Ad Hoc që afati prej 24-orësh për paraqitjen e ankesave në Gjykatën Supreme të mbetet ashtu siç parashikohet në LZP, si dhe afati 72-orësh për vendimin e Gjykatës Supreme. Prandaj, kjo pjesë e rekomandimit të EU EOM-së nuk do të zbatohet nëse ky propozim miratohet si i tillë.

Duke pasur parasysh se ligji nuk parasheh ankesa kundër rezultateve përfundimtare, por vetëm ankesa lidhur me votimin dhe numërimin në qendrat e votimit dhe procesin e tabelimit në QNR, gjë që ka krijuar vështirësi për PZAP-në i cili duhej të vlerësonte ndikimin e shkeljeve të supozuara në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve para se të publikoheshin rezultatet nga KQZ-ja, EU EOM 2021 sugjeroi që të **përfshihen dispozita për kontestimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të publikuara nga KQZ-ja si dhe për të sqaruar paqartësitë lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me votimin, numërimin, procesin në QNR dhe afatet e tyre përkatëse (Rek. prioritar nr.20)**. Në rekomandimet e tij drejtuar Komisionit Ad Hoc, PZAP ka propozuar që afati për paraqitjen e ankesave kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të jetë 48 orë, ndërsa PZAP ka propozuar që këto ankesa të bëhen brenda 96 orëve. PZAP-ja më tej i rekomandoi Komisionit që të vendosë një afat prej 24 orësh për paraqitjen e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të PZAP-së dhe Gjykatës Supreme të Kosovës t'i caktojë afatin prej 72 orësh për të vendosur për ankesën. Rrjedhimisht, nëse PZAP i miraton këto sugjerime, do të zbatohet rekomandimi i EU EOM-së, por në momentin e shkrimit të këtij raporti zbatimi i këtij rekomandimi është duke vazhduar.

V. TRYEZA E RRUMBULLAKËT E PALËVE TË INTERESUARA

Tryeza e palëve të interesuara u mbajt në Prishtinë më 2 dhjetor 2022. Agjenda u fokusua në fusha tematike specifike të rekomandimeve të EOM-së të vitit 2021 për: a) ndryshimet e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (regjistrimi i votuesve, votimi, numërimi dhe tabelimi), b) financimin e fushatës, dhe c) mjedisin mediatik dhe mediat sociale.

Qëllimi i tryezës ishte të bënte bashkë palët e interesit të përfshira në procesin e reformës zgjedhore që është duke vazhduar me qëllim të shkëmbimit të pikëpamjeve mbi progresin e bërë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të EU EOM 2021, sfidat gjatë punës së Komisionit Ad Hoc për Reformën Zgjedhore dhe miratimin e Ligjit të ndryshuar për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në këtë aktivitet morën pjesë zyrtarë të nivelit të lartë, përfshirë Kryetarin e Komisionit Ad Hoc, tre Komisionerë dhe Kryeshëfin Ekzekutiv të KQZ-së, një Komisioner dhe Zëvendës Kryeshëfin Ekzekutiv të KPM-së, një këshilltar të kabinetit të Kryetarit të Kuvendit, sekretarin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, përfaqësues nga shoqëria civile dhe ekspertë nga OSBE.

Tryeza u kryesua nga Shefi i Misionit të EFM-së dhe Shefi i Misionit të EU EOM 2021, z. Lukas Mandl, dhe Ambasadori Tomáš Szunyog, Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë.

Shefi i Misionit të EFM-së dhe Ambasadori i BE-së ndanë pikëpamjet e tyre për rëndësinë e procesit përcjellës si pjesë integrale e metodologjisë së BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, ndërsa Kryetari i Komisionit Ad Hoc informoi pjesëmarrësit për procesin e reformës legjislativë që është duke vazhduar. Tre komisionerët e KQZ-së morën fjalën për të prezantuar progresin në rishikimin e rregullave të KQZ-së. Të gjitha palët e interesuara përshëndetën kontributin e BE-së dhe rekomandimet zgjedhore të vitit 2021.

Pasoi një diskutim i gjallë, gjatë të cilit pothuajse të gjithë pjesëmarrësit shprehën pikëpamjet e tyre për reformën që është duke vazhduar, duke u fokusuar, gjatë sesionit të parë, në dy çështjet që do të diskutoheshin edhe gjatë takimeve të Komisionit Ad Hoc, të cilat ishin përtej rekomandimeve të EU EOM 2021, veçanërisht votimi jashtë Kosovës në ambasada dhe ndarja e procesit të numërimit ndërmjet vendvotimeve dhe komisioneve komunale zgjedhore.

Duke pranuar progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të EU EOM 2021 në fushën e financimit të fushatës, pjesëmarrësit nënvizuan se reforma është e pamjaftueshme për të siguruar transparencë, veçanërisht pasi nuk kërkohet raportim për shpenzimet e fushatës nga kandidatët individualë të subjekteve politike (partive). Komisioneri i KPM-së foli për arsyet e progresit të kufizuar të arritur në lidhje me rekomandimet e EOM-së për mediat.

Një nga aspektet shumë pozitive të tryezës ishte se disa parti më të vogla politike, të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe për rrjedhojë nuk marrin pjesë në Komisionin Ad Hoc, ishin të pranishme dhe patën mundësi të shprehnin pikëpamjet e tyre për procesin e reformës zgjedhore dhe shqetësimet e tyre përkatëse.

VI. PËRFUNDIMET

Rekomandimet e EU EOM 2021 ofruan disa sugjerime për të përmirësuar procesin zgjedhor në Kosovë, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e regjistrimit të votuesve dhe procesin e regjistrimit jashtë Kosovës, përafrimin e kriterëve të pranueshmërisë së kandidatëve me standardet ndërkombëtare, transparencën dhe mbikëqyrjen e financimit të fushatës, pavarësinë e transmetuesit publik dhe organit rregullator të mediave, reklamat zgjedhore në platformat online, promovimin e pjesëmarrjes së grave përmes politikave të brendshme partiake, procesin e zgjidhjes së kontesteve zgjedhore, performancën e këshillave të vendvotimeve dhe procesin e numërimit dhe tabelimit.

Dy prej këtyre rekomandimeve janë adresuar pjesërisht përmes ligjeve të reja për financimin e subjekteve politike. Disa rekomandime të tjera që kërkojnë ndryshimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme aktualisht janë duke u diskutuar gjatë procesit të reformës zgjedhore në vazhdim. Ekzistimi i një vullneti të duhur politik për adresimin e shpejtë të rekomandimeve të BE-së është deklaruar nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare që u takuan me EFM-në. Anëtarët e të gjitha grupeve parlamentare të Komisionit Ad Hoc, me të cilët u takua EFM, theksuan vendosmërinë për të mos hyrë në debate të politizuara gjatë diskutimeve të Komisionit Ad Hoc të cilat do të mund të vononin hartimin e projektligjit. Ata po ashtu shprehën sigurinë

e tyre për një proces të shpejtë për miratimin e projektligjit në Kuvend. Prandaj, mundësia dhe perspektiva që reforma zgjedhore të konkretizohet duket të jetë e mirë.

Procesi i reformës zgjedhore që sapo ka filluar në Kuvendin e Kosovës jep arsye për optimizëm të kujdesshëm mbi perspektivën për zbatimin e rekomandimeve të BE-së para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare të planifikuara për vitin 2025. Duket se ka një dinamikë për reformën shumë të vonuar zgjedhore për shkak të ekzistimit të një koalicioni të qëndrueshëm qeveritar dhe një konsensusi të gjerë midis palëve të interesit mbi nevojën për të adresuar përfundimisht rekomandimet e BE-së. Megjithatë, diskutimet e mundshme për ndryshime të tjera, si p.sh., për organizimin e votimit jashtë Kosovës nga ambasadat e Kosovës, i cili duket se gëzon mbështetjen e partisë në pushtet, mund ta komplikojë dhe vonojë këtë proces. Përveç kësaj, disa nga bashkëbiseduesit e shoqërisë civile në përgjithësi ishin skeptikë se mund të arrihet një reformë kuptimplotë në klimën aktuale politike në Kosovë, duke kujtuar përpjekjet e ngjashme të dështuara në vitin 2011.

Gjatë takimeve të saj me palët e interesuara dhe diskutimeve në tryezën e rrumbullakët, EFM-ja kërkoi që procesi i tanishëm i reformës të kryhet në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse për të ndërtuar besimin e elektoratit në rezultatin e tij.

ANEKSET

A. MATRICA MBI STATUSIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË EOM-SË

Nr.	Viti	Rekomandimi	Tema zgjedhore	Statusi (1-6)	Komentet dhe informacionet e tjera shtesë
1	2021	Formulimi i paqartë i paragrafit (d) të nenit 61.5 të LZP-së që mundëson largimin e kryesuesit ose një anëtarë nëse ata sillen ose veprojnë “në atë mënyrë që e dëmton seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së”, nuk është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare të cilat përcaktojnë se arsyet për largim duhet të “përcaktohen qartë dhe në mënyrë kufizuese në ligj”.	Administrimi i zgjedhjeve	2 Aktiviteti në vazhdim	Zbatimi i këtij rekomandimi është në vazhdim, pasi është themeluar Komisioni Ad Hoc për reformën zgjedhore për të adresuar rekomandimet e EU EOM-së. Ai kërkon ndryshimin e nenit 61.5(d) të LZP-së dhe anëtarët e Komisionit Ad Hoc për Reformën Zgjedhore theksuan synimin e tyre për të ndryshuar këtë dispozitë në projektligjin që do të përgatitet dhe do t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës në muajt e ardhshëm. Megjithatë, në këtë fazë të hershme të procesit të reformës nuk është e sigurt që kjo dispozitë do të ndryshohet përfundimisht.
2	2021	Të krijohet një pozitë administrative jopartiake e sekretarit të KVV-së për të ofruar këshilla dhe asistencën e nevojshme për KVV-në për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën e tyre.	Administrimi i zgjedhjeve	2 Aktiviteti në vazhdim	Ky rekomandim kërkon ndryshimin e LZP-së dhe një rregull të KQZ-së. Kjo është një nga çështjet që do të diskutohet gjatë seancave të Komisionit Ad Hoc që sapo kanë filluar dhe është përfshirë edhe në rekomandimet e KQZ-së për Komisionin.

3	2021	Tu jepen më shumë përgjegjësi KKZ-ve lidhur me edukimin dhe informimin e votuesve dhe gjithashtu për angazhimin e organizatave të shoqërisë civile në mbarë Kosovën. Duhet të adresohen grupe të veçanta të synuara, si gratë, votuesit në viset rurale, votuesit për herë të parë dhe personat me aftësi të kufizuara.	Administrimi i zgjedhjeve	2 Aktiviteti në vazhdim	Zbatimi i rekomandimit nuk kërkon ndonjë ndryshim ligjor. Anëtarët e KQZ-së informuan EU EFM-në se aktualisht janë duke shqyrtuar mundësitë se si ta zbatojnë atë.
4	2021	Aplikimi i një mekanizmi për heqjen automatike të personave të vdekur nga regjistri civil dhe baza e të dhënave të letërnjoftimeve të lëshuara pasi ARC të ketë marrë informatën nga spitalet dhe institucionet fetare.	Regjistrimi i votuesve	2 Aktiviteti në vazhdim	Agjencia e Regjistrimit Civil i raportoi EU EFM-së për përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet fetare në lidhje me raportimin e vdekjeve.
5	2021	Të përshpejtohet zhvillimi i një sistemi unik të adresave për të bërë më të saktë caktimin e votuesve në qendrat e votimit.	Regjistrimi i votuesve	1 Pa ndryshim	
6	2021	Të modernizohet metoda e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, për shembull, përmes një vegëze (link) në faqen e internetit të KQZ-së me masa të sigurisë, siç është verifikimi dy-faktorësh i aplikuesve në mënyrë që të sigurohet mbrojtja nga	Regjistrimi i votuesve	2 Aktiviteti në vazhdim	KQZ-ja informoi EU EFM-në se është duke zhvilluar një aplikacion softuerik me verifikim dy-faktorësh, që do të finalizohet deri në qershor 2023, që do t'u mundësojë votuesve jashtë Kosovës të aplikojnë dhe të regjistrohen online.

		mashtrimi dhe nga paraqitja e personave në emër të dikujt tjetër. (rekomandim me prioritet)			
7	2021	Të sigurohet ekzistimi i një mekanizmi për transmetimin e saktë dhe me kohë të të dhënave nga KGJK-ja për t'i mundësuar KQZ-së të bëjë një verifikim efikas dhe të besueshëm të evidencës penale të kandidatëve.	Regjistrimi i kandidatëve	Pa ndryshim	
8	2021	Të përcaktohet në ligjin për zgjedhjet se një kandidat e humb të drejtën për tu kandiduar vetëm nëse ka një dënim penal të formës së prerë për vepra të rënda penale dhe në bazë të një vendimi gjyqësor që shprehimisht i heq të drejtën për tu kandiduar.	Regjistrimi i kandidatëve	2 Aktiviteti në vazhdim	Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon ndryshim të nenit 29 të LZP-së. Anëtarët e Komisionit Ad Hoc e informuan EFM-në se kjo çështje do të përfshihet në diskutime. Përveç kësaj, edhe KQZ-ja në rekomandimet e saj drejtuar Komisionit sugjeroi që kjo çështje të diskutohet nga Komisioni.
9	2021	Të aplikohen masa për të zbatuar kufizimet e periudhës zyrtare të fushatës për raundin e dytë të zgjedhjeve ose të lejohet që fushata të fillojë menjëherë pas raundit të parë.	Ambienti i fushatës	1 Pa ndryshim	
10	2021	Ligji të parasheh raportimin e përkohshëm (të ndërmjetëm) të të ardhurave dhe shpenzimeve të	Financimi i fushatës	3	Ligji i ndryshuar paraqet një përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me kornizën e mëparshme ligjore dhe e adreson pjesërisht këtë

		garuesve gjatë periudhës së fushatës, si dhe raportimin përfundimtar brenda 30 ditësh nga dita e zgjedhjeve. Raportimi duhet të përfshijë financat e kandidatëve të emëruar nga partitë dhe subjekteve që bëjnë fushatë për garuesit (palët e treta). Ligji të përcaktojë një afat të shkurtër për autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet politike që të publikojnë të gjitha raportet financiare në mënyrë lehtësisht të kërkueshme.		Pjesërisht i zbatuar.	rekomandim. Megjithatë, kërkesat për raportim nuk zbatohen për kandidatët individualë të nominuar nga partitë politike dhe për subjektet që bëjnë fushatë për garuesit (palët e treta).
11	2021	Të sigurohet një mekanizëm i pavarur për mbikëqyrjen efektive të financave të partive dhe fushatave, të cilit i jepet mandati, autoriteti, si dhe burimet financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe hetuar në mënyrë efektive dhe proaktive parregullsitë e supozuara në financimin e partive dhe fushatave, përfshirë edhe të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara dhe shqiptimin e ndëshkimeve. (rekomandim me prioritet)	Financimi i fushatës	2 Aktiviteti në vazhdim	Në shtator 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj për ndryshimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike (LFPP) dhe LZP-së, të cilat parashohin krijimin e një Zyre të pavarur për monitorimin e partive politike në kuadër të strukturës së KQZ-së. Zyra u themelua më 20 shtator 2022; KQZ aktualisht është duke hartuar rregulloret përkatëse dhe është duke vazhduar procesin e përzgjedhjes së drejtorit të ri. Ndonëse ligji i ri përcakton parimet për një autoritet të pavarur, zbatimin aktual të kësaj kornize të re ligjore, e cila do të përmbushte kështu rekomandimin e EU EOM-së, nuk mund të vlerësohet në këtë fazë.

12	2021	Të forcohet pavarësia e transmetuesit publik nga ndërhyrjet e mundshme politike, duke rishikuar sistemin e financimit të tij.	Media	Pa ndryshim	
13	2021	Të fillohet zbatimi i dispozitave rregullative specifike që synojnë sigurimin e pluralizmit mediatik dhe transparencën mbi pronësinë e mediave.	Media	Aktiviteti në vazhdim	Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka hartuar projekt-rregullore për pronësinë e mediave, por ende nuk janë miratuar.
14	2021	Të emërohen me kohë të gjithë anëtarët e KPM-së dhe të Bordit të Ankesave të KPM-së përmes një procesi përzgjedhës konkurrues dhe transparent për të nxitur pavarësinë, mbikëqyrjen dhe fuqinë sanksionuese të organit rregullator. (rekomandim me prioritet)	Media	Pa ndryshim	Derisa Kuvendi i Kosovës ka bërë tri emërimet e reja në KPM në vitin 2022, kanë skaduar mandatet e anëtarëve të tjerë dhe Komisioni vazhdon të mbetet pa kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje.
15	2021	Të përfshihen dispozita për reklamat zgjedhore në platformat online dhe të zgjerohen në mënyrë eksplicite rregullat ekzistuese të fushatës për të mbuluar edhe sferën digjitale. (rekomandim me prioritet)	Komunikimi digjital dhe mediat sociale	Pa ndryshim	

16	2021	Të nxitet e bashkëpunimit ndërmjet administratës së zgjedhjeve dhe ofruesve kryesorë digjitalë për të inkurajuar krijimin e arkivave të detyrueshme për reklamat zgjedhore në internet me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për shpenzimet e fushatës. Mund të aplikohet një rregullore për subjektet politike dhe kandidatët që synojnë të zhvillojnë fushatë në platformat online për t'u regjistruar si reklamues politikë.	Komunikimi digjital dhe mediat sociale	Pa ndryshim	
17	2021	Partitë politike të marrin parasysh miratimin e politikave të brendshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe për të integruar çështjet gjinore në platformat partiake.	Pjesëmarrja e grave	2 Aktiviteti në vazhdim	Derisa partitë kryesore raportuan përpjekje të vazhdueshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave si kandidate dhe brenda strukturave partiake, disa shpallën vendime konkrete politike, veçanërisht PDK-ja që shpalli synimin për përfaqësimin 50/50 të grave në të gjitha nivelet e organizimit dhe vendimmarrjes.
18	2021	Të miratohet dhe transpozohet KDPAK e OKB-së në Kushtetutë, në mënyrë që të zbatohen të drejtat e garantuara në të.	Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara	1 Pa ndryshim	Transpozimi i KDPAK të OKB-së në Kushtetutë është ende prioritet i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara i cili po planifikon të formojë një grup avokues në vitin 2023 për të bërë fushatë për këtë ndryshim.
19	2021	Të zgjaten afatet për paraqitjen e parashtrësive apo ankesave zgjedhore, dhe për PZAP-në dhe GJS-në për t'i gjykuar ato, në tri	Kontestet zgjedhore	2	Zbatimi i këtij rekomandimi është i lidhur me punën e Komisionit Ad Hoc, e cila aktualisht është duke vazhduar. Rekomandimet e PZAP-së për Komisionin Ad Hoc janë përgjithësisht në përputhje me këtë

		deri në pesë ditë (si për paraqitjen e parashtrësive dhe ankesave ashtu edhe për gjykimin e tyre).		Aktiviteti në vazhdim	rekomandim, me përjashtim të zgjatjes së afateve për Gjykatën Supreme.
20	2021	Të përfshihen dispozita për kontestimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të publikuara nga KQZ-ja. Të sqarohen paqartësitë lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me votimin, numërimin, procesin në QNR dhe afatet e tyre përkatëse. (rekomandim me prioritet)	Kontestet zgjedhore	2 Aktiviteti në vazhdim	Zbatimi i këtij rekomandimi është i lidhur me punën e Komisionit Ad Hoc, e cila aktualisht është duke vazhduar. Rekomandimet e PZAP-së për Komisionin Ad Hoc janë në përputhje edhe me këtë rekomandim.
21	2021	Të intensifikohet trajnimi i stafit zgjedhor për të adresuar mangësitë e vazhdueshme siç është mosrespektimi i vazhdueshëm i procedurave të numërimit të votave dhe plotësimi i gabuar i formularëve të rezultateve.	Votimi, numërimi dhe tabelimi	5 Është shumë herët në ciklin zgjedhor për ta përcaktuar	Është shumë herët të vlerësohet zbatimi i këtij rekomandimi, pasi trajnimi i stafit të votimit bëhet disa javë para ditës së zgjedhjeve.
22	2021	Votimi i asistuar në vendvotime të rregullohet në mënyrë më të rreptë, për shembull duke kërkuar që personi që ndihmon një votues të jetë i regjistruar në të njëjtin vendvotim.	Votimi, numërimi dhe tabelimi	2 Aktiviteti në vazhdim	KQZ-ja në rekomandimet e saj drejtuar Komisionit Ad Hoc e mbështet plotësisht këtë rekomandim, duke sugjeruar që personi që asiston duhet të jetë votues në të njëjtën qendër votimi me votuesin me aftësi të kufizuara. Prandaj, nëse Komisioni Ad Hoc e miraton këtë sugjerim, ai do të zbatohet plotësisht rekomandimin përkatës të BE-së.

23	2021	Të ridizajnohen fletëvotimet e zgjedhjeve për kuvendet komunale për tu kuptuar më mirë nga votuesit dhe të shtohen informacionet për votuesit se si të shënojnë si duhet fletëvotimin në mënyrë që të zvogëlohet numri i votave të pavlefshme. (rekomandim me prioritet)	Votimi, numërimi dhe tabelimi	2 Aktiviteti në vazhdim	KQZ është në proces të ridizajnimit të fletëvotimit për zgjedhjet parlamentare dhe aktualisht po kryen një testim të dy opsioneve të ndryshme. Prandaj, zbatimi i këtij rekomandimi është në vazhdim e sipër.
----	------	---	-------------------------------	--------------------------------	---

Shënime udhëzuese

Shtylla 1: Numri lidhet me numrin e rekomandimit në Raportin Përfundimtar të EOM-së

Shtylla 2: Ku kanë qenë dy EOM brenda një viti p.sh. 2017, i pari duhet të shkruhet si 2017(1) dhe i dyti duhet të shkruhet si 2017(2)

Shtylla 3: Duhet të futet teksti i rekomandimit. Rekomandimet prioritare duhet të shkruhen me shkronja **të zeza të theksuara (bold)**.

Shtylla 4: 'Temat zgjedhore' janë fushë tematike në kuadër të së cilës paraqitet rekomandimi në Raportin Përfundimtar të EOM-së p.sh. Korniza zgjedhore/ligjore, Administrimi i zgjedhjeve, Regjistrimi i votuesve, Financimi i fushatës, Mediat, Procedurat e votimit etj.

Shtylla 5: Statusi i zbatimit të një rekomandimi duhet të zgjidhet nga sa vijon:

Kategoria	Përshkrimi	Udhëzime
1	Pa ndryshim	Nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e këtij rekomandimi.
2	Veprimi apo aktiviteti është në vazhdim e sipër por zbatimi i rekomandimit nuk është konfirmuar ende	Shembujt mund të përfshijnë formimin e një grupi punues për rishikimin e legjislacionit, ose përgatitjen e një projektligji të reformës, por ndryshimi ende nuk është konfirmuar me ndryshim legjislativ.
3	Zbatim i pjesshëm i rekomandimit	Rekomandimi është adresuar/zbatuar pjesërisht, por nuk janë adresuar elementet e tjera të rekomandimit.
4	Zbatim i plotë i rekomandimit	Rekomandimi është zbatuar në tërësi p.sh. legjislacioni zgjedhor është ndryshuar dhe janë adresuar të gjitha aspektet e rekomandimit.

5	Është tepër herët në ciklin zgjedhor për ta përcaktuar	Disa rekomandime mund të lidhen me veprim/praktikë administrative e cila mund të vlerësohet vetëm në një fazë të mëvonshme, p.sh. forcimi i informimit të qytetarëve/votuesve.
6	Rekomandimi nuk është më relevant	Për shembull, një ndryshim në sistemin zgjedhor mund të bëjë të tepërt rekomandimin për regjistrimin e kandidatëve sipas sistemit të vjetër zgjedhor.

Shtylla 6: Komentet për statusin e zbatimit p.sh. qeveria/shumica parlamentare nuk e mbështet rekomandimin.

B. KOMUNIKATË PËR SHYTP



KOMUNIKATË PËR SHYTP

BE-ja mirëpret reformën zgjedhore që po vazhdon dhe inkurajon ligjvënësit që të hartojnë dhe miratojnë ndryshime në ligjet përkatëse në mënyrë gjithëpërfshirëse

PRISHTINË, 2 dhjetor 2022 – Misioni Përcjellës i Zgjedhjeve i BE-së (EFM), i vendosur në Kosovë që nga 14 nëntori 2022 prezantoi sot gjetjet e tij preliminare mbi progresin e arritur deri më tani në zbatimin e rekomandimeve të Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve.

“Ne mirëpresim progresin në fushën e financimit të fushatave dhe jemi të inkurajuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që është duke finalizuar rishikimin e rregullave të tij. BE-ja fton ligjvënësit që të adresojnë rekomandimet e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve me një konsensus të gjerë dhe vullnet politik”, tha shefi i EU EFM-së, Lukas Mandl.

“Unë inkurajoj Komisionin Ad Hoc të Kuvendit të Kosovës për Reformën Zgjedhore që të vazhdojë të angazhohet me të gjitha palët e interesuara në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse për të ndërtuar një nivel më të madh të besimit të publikut në procesin zgjedhor”, shtoi ai.

BE-ja në Kosovë monitoron vazhdimisht zbatimin e rekomandimeve të Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve.

“Puna në përmirësimin e procesit zgjedhor ka filluar dhe ne duam që ajo të çojë në përfundimin e reformës zgjedhore, e cila është pjesë e rëndësishme e procesit të integritetit evropian të Kosovës,” tha Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog.

Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve 2021 ka bërë 23 rekomandime, duke përfshirë gjatë me prioritet, duke u fokusuar, ndër të tjera, në regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, financimin e partive dhe fushatave, fushatën në media dhe online, si dhe qartësimin e dispozitave për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

“Shumë prej rekomandimeve të vitit 2021 janë të ngjashme me ato të bëra nga misionet e mëparshme të BE-së dhe ne do të vazhdojmë të kontribuojmë në proceset zgjedhore demokratike në Kosovë duke ndihmuar në përmirësimin e kornizës zgjedhore”, tha Mandl.

EU EFM, e kryesuar nga Lukas Mandl, deputet i Parlamentit Evropian dhe ish-Shef i Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për zgjedhjet komunale të vitit 2021, u vendos në Kosovë më 14 nëntor. Objektivat kryesore të këtij misioni janë të vlerësojë shkallën se sa janë zbatuar rekomandimet e BE-së për përmirësimin e kornizës zgjedhore, si dhe të diskutojë mënyrat për të arritur progres të mëtijshëm në reformën zgjedhore. Misioni do të qëndrojë në Kosovë deri më 8 dhjetor.

EFM u takua me përfaqësues të Komisionit Ad Hoc të Kuvendit për Reformën Zgjedhore, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Komisionin e Pavarur për Media, partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin ndërkombëtar. Një raport përfundimtar gjithëpërfshirës i misionit përcjellës të zgjedhjeve të BE-së do të publikohet në javët e ardhshme.

Arkivi i plotë i raporteve dhe rekomandimeve të EU EOM-së mund të gjendet në <http://database.eucom.eu>, për raportin e EU EOM 2021 në Kosovë, ju lutem shikoni:

Mbulimi i Konferencës së Shtypit të EU EFM në mediat lokale

<https://kosovapress.com/en/the-eu-expects-the-recommendations-for-electoral-reform-to-to-addressed/>

<https://ekonomiaonline.com/politike/be-ja-e-gatshme-ta-ndihmoje-reformen-zgjedhore-szunyog-thote-se-presin-rezultate-gjitheperfshirese/>

